

Të gjeturat e këtij studimi tregojnë se në përgjithësi qytetarët nuk janë shumë aktiv në jetën publike qoftë në nivelin lokal, qendror, parti politike apo edhe në komunitetet e tyre. Gjithashtu, institucionet e të dyja niveleve nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për t'i dëgjuar dhe pastaj adresuar kërkesat e qytetarëve. Në këtë aspekt, më mirë qëndron qeverisja lokale se sa ajo qendrore duke qenë se 47.7% e qytetarëve kanë dëgjuar për ndonjë konsultim publik të organizuar nga Kryetari apo Kuvendi Komunal në dy vitet e fundit në komunën e tyre, krahasuar me vetëm 9.4% të atyre që pohuan se kanë marrë pjesë në ndonjë konsultim publik të organizuar nga Kuvendi i Kosovës.

Qëndrim të ngjashëm qytetarët kanë edhe për sa i përket organizimit të konsultimeve nga deputetët, me vetëm 35.5% të respondentëve që tregojnë gatishmëri të marrin pjesë në një konsultim në lagje të tyre nëse një i tillë organizohet nga deputetë(t). Mirëpo edhe në nivel të komunave, angazhimi institucional për t'i mbajtur qytetarët afér qeverisjes ka hapësirë për përmirësim. Kjo vlen sidomos në aspektin e promovimit të mundësive për angazhim, konkretisht informimit më të mirë të qytetarëve për mekanizmat e konsultimit si dhe rreth organizimit të konsultimeve publike.

Fakti që 56.9% të qytetarëve kanë thënë se do të merrnin pjesë në një konsultim nëse do të informoheshin për një të tillë dhe 67.4% të tyre nuk kanë marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga komuna sepse nuk kanë qenë të informuar, tregon që komunat janë përgjegjëse në masë të madhe për pjesëmarrje të vogël të qytetarëve në konsultime. Për më tepër, shqetësuese është e gjetura se 51% të qytetarëve nuk marrin pjesë në këto ngjarje sepse besojnë që kërkesat e tyre nuk merren parasysh.

Në anën tjeter, interesimi i qytetarëve për angazhim në jetë publike nuk është në nivelin e duhur. Kjo tregohet nga përqindja e vogël e qytetarëve që kërkojnë përgjigje nga zyrtarët përgjegjës, ku 16.3% e respondentëve pohojnë se kanë kërkuar takim me kryetarin, 9.9% i kanë telefonuar komunës për ankesa/kërkesa, 9.4% kanë kontaktuar me komunën apo kryetarin përmes rrjeteve sociale dhe vetëm 3.8% kanë raportuar online për ndonjë ankesë.